

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9917, DATË 19.5.2008, “PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është mbrojtja e sistemit financiar dhe e ekonomisë në tërësi nga kërcënimet e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, duke forcuar integritetin e sistemit parandalues në vend dhe duke kontribuar për paqen dhe sigurinë. Në funksion të këtij qëllimi të përgjithshëm synohet:

- a) zvogëlimi i rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nëpërmjet politikave, koordinimit dhe bashkëpunimit;
- b) parandalimi i hyrjes së produkteve të veprave penale apo veprimtarisë kriminale, si dhe i fondeve në mbështetje të terrorizmit në sektorin financiar apo në sektorë tjerë ose zbulimi dhe raportimi i tyre;
- c) zbulimi dhe goditja e kërcënimeve për pastrim të parave/ financim terrorizmi, si dhe dënimi e zhveshja e autorëve nga përfitimet e paligjshme.

Arritja e synimeve të mësipërme realizohet nëpërmjet përafrimit të legjislacionit me rekomandimet e Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (*Financial Action Task Force – FATF*), i cili përcakton standardet dhe nxit zbatimin efektiv të masave ligjore, rregullative dhe operacionale për luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe kërcënime të tjera që lidhen me integritetin e sistemit financiar ndërkombëtar.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj përputhet me programin politik qeverisës 2017-2021 në angazhimet e shprehura në kuadër të “Sigurisë kombëtare dhe kontributit për sigurinë globale”, si pjesë e pjesës së katërt “Politika e jashtme dhe e sigurisë, integrimi evropian dhe shqiptarët në botë”, ku parashikohet “përmirësimi dhe

modernizimi i mëtejshëm i menaxhimit të kufijve, rritja e kapaciteteve të bashkëpunimit dhe të shkëmbimit ndërkombëtar të të dhënave dhe informacionit do të kontribuojnë në parandalimin dhe frenimin e qarkullimit ndërkufitar të krimit, terrorizmit, financave kriminale dhe migracionit të paligjshëm”.

Gjithashtu, hartimi i projektligjit është miratuar si detyrë dhe përparësi më 4.9.2018, nga Komiteti për Bashkërendimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave¹ i kryesuar nga Kryeministri dhe me anëtar të gjitha organet relevante të fushës.

Projektligji është pjesë e programit analitik të projektakteve për vitin 2019.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Sistemi shqiptar i parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit i është nënshtruar vlerësimit në kuadër të raundit të pestë Vlerësimit për Shqipërinë kryer nga Komiteti *Moneyval* i Këshillit të Evropës², që është organi rajonal që vlerëson për vendin tonë përputhshmërinë me rekomandimet e FATF-së. Ky vlerësim ka identifikuar nevojat dhe ka bërë rekomandimet përkatëse në funksion të përputhshmërisë teknike me Rekomandimet e FATF-së.

Me këtë projektligj synohet përmbushje e një pjese të rekomandimeve dhe/ose kriterëve përkatëse të rekomandimeve, me fokus ato që janë vlerësuar si të papambushura apo të përmbushura pjesërisht.

Në pasqyrim të gjetjeve të mësipërme dhe në funksion të rritjes së efektivitetit dhe të përputhshmërisë teknike të sistemit tonë të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, janë përpiluar dhe amendamentet që përmban ky projektligj.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI, VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji që propozohet për miratim do të ketë vendin e tij në rendin juridik shqiptar, i cili përcaktohet nga shkronja “c”, pika 1, neni 116, i Kushtetutës.

¹ Funkcioni dhe përbërja e Komitetit përcaktohen në nenin 23, të ligjit nr.9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar.

² Raporti i plotë gjendet në: <https://rm.coe.int/committe-of-experts-on-the-evaluation-of-anti-money-laundering-measur/16808ff138>.

Baza ligjore për propozimin e këtij projektligji, sipas hierarkisë ligjore, janë nenet 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës.

Zbatimi i rekomandimeve të FATF-së, të cilat, përveçse janë botërisht të pranuar dhe ka mekanizma ndëshkimi për mosndjekje, për vendin tonë është detyrim që rrjedh nga neni 13, i Konventës së KiE-së, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr.9646, datë 27.11.2006, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit””.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BASHKIMIT EVROPIAN (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Aktet e Bashkimit Evropian që rregullojnë këtë fushë janë:

- Direktiva (BE) 2015/ 849 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 20 majit 2015; dhe
- Direktiva (BE) 2018/843 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 30 majit 2018.

Qëllimi i këtij projektligji është përmbushja e detyrave të dala nga vlerësimi i Komitetit *Moneyval*, pra, përafrimi me rekomandimet e FATF-së dhe jo përafrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë me direktivat e mësipërme.

Në funksion të përafrimit me direktivat e Bashkimit Evropian të fushës, të cilat janë ende në procese ndryshimi, brenda një periudhe afatmesme, parashikohet hartimi i një ligji të ri, proces i cili nuk është i mundur të kryhet në këtë fazë.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Përveç shpjegimeve të dhëna si më poshtë, një pjesë e ndryshimeve janë shoqëruar me shënim në fund të faqes, duke evidentuar kriterin përkatës të secilit rekomandim të FATF-së, të synuar për përafrim.

1. Neni 2, pas pikës 3 shtohet pika 3/1. Qëllimi është sqarimi i termit të shërbimeve korrespondente nga bankat dhe institucionet tjera financiare.
2. Neni 2, pika 7 ndryshohet me qëllim sqarimin e kuptimit të marrëdhënies së biznesit.
3. Neni 2, në fund të pikës 10, shtohet fjali në mënyrë që të caktohet kohëzgjatja e statusit të personit të ekspozuar politikisht.
4. Neni 2, pika 11 ndryshohet. Sipas raportit të *Moneyval*-it përkufizimi i produkteve të veprimtarisë kriminale është i ngushtë dhe mungon

përpunimi i kuptimit të fondeve që rrjedhin nga veprimtaria kriminale. Me ndryshimet e propozuara synohet sqarimi i fushës së zbatimit të detyrimit për raportim.

5. Neni 2, në pikën 12 shtohet shprehje në mënyrë që koncepti i pronarit përfitues të shtrihet edhe tek organizimet ligjore.
6. Neni 2, pas pikës 13 të këtij neni, shtohet fjali në mënyrë që të sqarohet termi “fond”.
7. Neni 2, pika 16 ndryshohet. Sipas raportit të *Moneyval*-it ka raste të transaksioneve të mbetura në tentativë, që nuk përfshihen qartë në ligj, si dhe/apo përkufizimi i termit transaksioni nuk shtrihet ndaj transaksioneve të kryera nga një klient me llogari të tij. Me ndryshimet e propozuara synohet që detyrimi për raportim të shtrihet për të gjitha transaksionet.
8. Në nenin 2 shtohen si përkufizime termat “Mjet virtual” dhe “Ofrues i shërbimeve të mjeteve virtuale”, në mënyrë që këto aktivitete të përfshihen edhe në gamën e subjekteve raportuese.
9. Në nenin 3 janë bërë sisteme dhe qartësim të llojit të subjekteve raportuese.
10. Pas nenit 3 shtohet 3/1. Me ndryshimet e propozuara synohet që organizimet ligjore të bëjnë të ditur statusin e tyre tek subjektet raportuese kur të vendosin një marrëdhënie biznesi apo të kryejnë një transaksion mbi kufirin³, si dhe që vigjilenca e duhur të përfshijë edhe detyrimin për të mbajtur informacionin bazik lidhur agjentët e rregulluar dhe ofruesit e shërbimeve për organizimet ligjore, duke përfshirë këshilltarët e investimeve apo menaxherët, llogaritarët dhe këshilltarët fiskalë⁴.
11. Neni 4 ndryshon në mënyrë që të hiqen limitet e raportimit të parashikuara në atë nen.
12. Në nenin 4/1, në pikën 1, shkronja ‘g’, nënndarjet “ii” dhe “iii” ndryshohet për përafrim më të saktë me rekomandimin përkatës⁵, për rastet kur verifikimi i identitetit të klientit dhe pronarit përfitues mund të kryhet në një moment të dytë nga subjekti.
13. Në nenin 4/1, pas pikës 1, shkronja “h”, shtohet pikat 1/1. Me ndryshimet e propozuara synohet saktësimi i detyrimit⁶ të subjekteve raportuese për të verifikuar autorizimin, si dhe për të identifikuar dhe verifikuar identitetin e përfaqësuesit të shtrihet për të gjithë klientët, persona fizikë, persona juridikë dhe organizime ligjore.
14. Shtohet neni 4/2, duke futur konceptin e vigjilencës së thjeshtuar.
15. Neni 5 ndryshohet për të saktësuar llojin e dokumenteve dhe të dhënave që duhet të merren nga subjektet për klientët e tyre.

³ Kriteri 25.3

⁴ Kriteri 25.1

⁵ Kriteri 10.14

⁶ Kriteri 10.4

16. Në nenin 6 bëhen ndryshime në mënyrë që masat përkatëse të zbatohen përpara futjes në përdorim të produkteve të reja dhe praktikave të biznesit apo teknologjive të reja për produktet e reja dhe ekzistuese.
17. Pas nenit 6 shtohet neni 6/1. Me ndryshimet e propozuara synohet që të lejohet mbështetja tek palët e treta⁷ nga ana e subjekteve të ligjit, të përcaktohen kushtet për lejimin e mbështetjes, rastet e ndalimit të mbështetjes tek palët e treta, si dhe përgjegjshmëria për mospërmbyllje të detyrimeve.
18. Neni 7 ndryshohet, duke saktësuar që masat e kërkuara zbatohen edhe për financim të terrorizmit⁸.
19. Neni 8 ndryshohet:
- a) Duke përfshirë në një nen kategoritë e klientëve dhe transaksioneve, ndaj të cilëve zbatohet vigjilenca e zgjeruar, veprim ky që qartëson masat dhe detyrimet.
 - b) Raporti i *MONEYVAL* nënvizon mungesën e kërkesave për të identifikuar nëse përfituesit apo pronarët përfitues të kontratave të sigurimit të jetës janë persona të ekspozuar politikisht⁹ dhe të merren masat përkatëse.
 - c) Në raport është nënvizuar se mungojnë parashikimet për masat e zbatueshme në rast të identifikimit të rreziqeve që lidhen me kategori subjektsh të ndryshme nga ato të parashikuara nga ligji si dhe se nuk kërkohet në mënyrë specifike që në një kontratë sigurimi jete përfituesi të konsiderohet faktor risku. Me ndryshimet e propozuara synohet që:
 - subjektet t’u kushtojnë vigjilencë të zgjeruar marrëdhënieve të biznesit dhe transaksioneve me klientë, të cilët vetë subjekti i ka kategorizuar me risk të lartë apo nëse gjatë një transaksioni apo marrëdhënie biznesi identifikohen rreziqe të larta që nuk janë evidentuar më parë¹⁰;
 - përfituesi i policave të sigurimit të jetës të konsiderohet si një faktor risku për të përcaktuar zbatimin ose jo të masave të vigjilencës së zgjeruar;
 - nëse përcaktohet që përfituesi, person fizik, juridik apo organizim ligjor paraqet rrezik të lartë, duhet të zbatohen masat e vigjilencës së zgjeruar që përfshijnë marrjen e masave për identifikimin dhe verifikimin e identitetit të pronarit përfitues, në momentin e pagesës¹¹.

⁷ Kriteret 17.1-17.3 etj

⁸ Kriteri 10.17

⁹ Kriteri 12.4

¹⁰ Kriteri 1.11

¹¹ Kriteri 10.13

20.Neni 9 ndryshohet. Ndryshimi kryesor ka të bëjë me kalimin e kategorisë së transaksioneve për të cilat ushtohet vigjilencë e zgjeruar në nenin 8, e, për këtë arsye, neni 9 tanimë ka vetëm detyrimet që lidhen me bankat/institucionet korrespondente. Pjesa tjetër e ndryshimeve është saktësim i detyrimeve që rrjedhin nga rekomandimi 13 dhe kriteret përkatëse.

21.Neni 10 ndryshohet. Me amendamentet e propozuara synohet që:

- institucionet financiare dhe/ose ndërmjetëse të marrin masa të arsyeshme për identifikimin e transfertave ndërkufitare që kanë mangësi në informacionin rreth urdhëruesit apo përfituesit si dhe të zbatojnë politika e procedura të bazuara për rrezikun, për të përcaktuar hapat që do ndiqen¹².
- për transfertat ndërkufitare mbi pragun e parashikuar në ligj, subjektet financiare përfituese të verifikojnë identitetin e përfituesit, nëse ky proces nuk është kryer më parë¹³.
- subjektet të bllokojnë transfertat e parave ose vlerave me persona të shpallur¹⁴.

22.Pas nenit 10, shtohet neni 10/115. Me ndryshimet e propozuara synohet që:

- subjektet e këtij ligji, organet publike, si dhe çdo person në Republikën e Shqipërisë, të zbatojë menjëherë, nga marrja dijeni, bllokimin e përkohshëm të çdo veprimi, transaksioni, transferte, fondi dhe pasurie tjetër, menjëherë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa e kushtëzuar procesin me miratimin e akteve të mëtejshme ligjore brenda vendit;
- të përcaktohen veprimet që kryhen në zbatim të bllokimit të përkohshëm;
- të parashikohet detyrimi i subjekteve për bllokim pa vonesë;
- shtrirja detyrimit për bllokim tek subjektet, organet publike, si dhe çdo person në Republikën e Shqipërisë.

Kjo ndërhyrje parashikohet në këtë ligj pasi, në thelb, raporti i vlerësimit të *MONEYVAL* ka konkluduar se ligji nr.157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, nuk garanton zbatimin pa vonesë (që tanimë interpretohet si

¹² Kriteret 16.11 & 16.2

¹³ Kriteri 16.14

¹⁴ Kriteri 16.8

¹⁵ Rekomandimi 6

çështje orësh dhe që duhet të gjejë zbatim menjëherë) të sanksionimeve të KS-së të OKB-së në lidhje me terrorizmin dhe/ose financimin e tij.

23.Neni 11 ndryshohet. Me ndryshimet e propozuara synohet që të saktësohen detyrimet që kanë subjektet raportuese, si:

- të identifikojnë, të vlerësojnë dhe të kuptojnë rreziqet e tyre të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit¹⁶;
- të marrin masa shtesë për të menaxhuar dhe zbutur rreziqet e larta kur identifikohen¹⁷;
- të zbatojnë detyrimet e parashikuara në përputhje me rreziqet për pastrim parash dhe financim terrorizmi, si dhe përmasat e subjektit¹⁸;
- subjektet që janë pjesë e grupeve financiare, të zbatojnë programet e grupit kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, për sa janë në përputhje me detyrimet e parashikuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij¹⁹.

24.Në nenin 12, hiqen shprehje në mënyrë, që të mos ketë pengesa formale për zbatimin e detyrimit për raportim.

25.Neni 14 ndryshohet. Raporti nënvizon se është e paqartë nëse koncepti “sekret profesional” shtrihet edhe tek zbulimi i informacionit të mbrojtur me kontratë, ligj apo akt administrativ. Prandaj, me amendamentet e propozuara synohet që përjashtimi nga përgjegjësia për shkelje të sekretit profesional për raportim tek DPPPP-ja të shtrihet edhe tek përgjegjësia që lind për shkak kontrate, ligji apo akti administrativ²⁰.

26.Neni 16 ndryshohet. Me amendamentet e propozuara synohet që të saktësohet lloji dhe cikli i dokumenteve që duhet të ruhen nga subjektet²¹ dhe afati përkatës i ruajtjes.

27.Neni 17 ndryshohet dhe pas tij shtohet neni 17/1. Qëllimi i këtij ndryshimi për nenin 17 është saktësimi dhe ndarja e detyrimit që kanë organet doganore nga ai i personave që duhet të deklarojnë në hyrje/dalje nga territori i Republikës së Shqipërisë. Më tej, neni 17/1 fut konceptin e gjobës së pakthyeshme, me pragje dhe kushte, për rastet e mosdeklarimit,

¹⁶ Kriteri 1.10

¹⁷ Kriteri 1.11-c

¹⁸ Kriteri 18.1

¹⁹ Kriteri 18.2

²⁰ Kriteri 21.1

²¹ Kriteri 11.2

si instrument që konsiderohet që shton efektivitetin, krahas ndjekjes së mundshme penale. Praktika e gjobës me përqindje mbi shumën e padeklaruar njihet nga disa vende të Bashkimit Evropian.

28. Pas nenit 21 është shtuar neni 2/1, pasi sipas vlerësimit të *MONEYVAL*-it, nuk ka afat të përcaktuar qartë për subjektet dhe institucionet për të kthyer përgjigje për kërkesat për informacion të DPPPP-së.

29. Neni 22 është ndryshuar me qëllim:

- a) qartësimin e llojit të aksesit në informacion që ka të drejtë të ketë DPPPP, në ushtrim të detyrave funksionale;
- b) qartësimin e organeve me të cilat DPPPP-ja shkëmben informacion;
- c) rregullimin e kompetencës për kufizim transaksionesh dhe/ose kontroll, për vendet me risk²².

30. Neni 23 është ndryshuar me qëllim saktësimin e anëtarëve të Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave, si dhe futjen e anëtarëve të rinj në këtë komitet, që janë drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe drejtori i Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

31. Neni 27 ndryshohet. Sipas raportit të *MONEYVAL*, gjobat e parashikuara në ligj nuk janë të shumëllojshme, të përshkallëzuara dhe më tej as bindëse në vlerë në rastet kur vendosen. Për këtë qëllim është rikonceptuar si nen, në logjikë të rekomandimeve të FATF-së. Gjithashtu, është parashikuar rritja e afatit të shqyrtimit të masave administrative, për shkak të rëndësisë dhe pasojave që mund të kenë për vendin shkelje të rënda subjekteve, numrit shumë të lartë të subjekteve raportuese, por edhe në linjë me afatet që përdoren aktualisht në këtë fushë.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTAKTI

Për zbatimin e këtij projektligji përgjithësisht ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, autoritetet mbikëqyrëse dhe subjektet e ligjit.

²² Kriteri 19.2

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, e cila ka konsultuar informalisht këtë projektligj me bankat e nivelit të dytë, shoqëritë e transfertave, Shoqatën e Bankave, Bankën e Shqipërisë, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji nuk ka efekte të paparashikuara në buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE